



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT
VLORË

Nr. 1862 /678/ 25 Regj. Themeltar
Dt. Regj 25.01.2016

Nr. 152 Vendimi
Dt. Shpalljes 08.03.2018

VENDIM
« NË EMËR TË REPUBLIKËS »

Gjykata e Apelit Vlorë e përbërë nga:

KRYESUES : BRIKENA UKPERAJ
ANËTAR : NAZMI TROKA
ANËTARE : MARGARITA BUHALI

asistuar prej sekretares gjyqësore [REDACTED] sot në datë 08.03.2018, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike në shkallë të dytë, çështjen civile me Nr. 1862 /678/ 25 Regj Them, që i përket :

PADITËS:

[REDACTED] me atësi [REDACTED] dhe amësi [REDACTED] i dtl. [REDACTED] lindur dhe banues në [REDACTED] Patos, përfaqësuar nga av. [REDACTED] (në mungesë në shpalljen e vendimit).

E PADITUR:

Shoqëria tregtare "Albpetrol" sh.a Patos Fier, me Zyrë Qendrore të ushtrimit të veprimtarisë në Patos Fier, përfaqësuar nga z. [REDACTED] (në mungesë në shpalljen e vendimit).

PERSON I TRETË:


Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi Tiranë (në mungesë).

OBJEKTI:

1) Konstatimi i faktit të diskriminimit dhe viktimizimit ndaj paditesit, e kryer nga ana e punedhësit Albpetrol sh.a, Patos.

2) Ndreqja e shkeljeve ligjore dhe pasojave të ardhura, duke detyruar punedhësin Albpetrol sh.a, Patos që të riktheje paditesin në vendin e mëparshëm të punës, në pozicionin e shefit të sektorit të stacionit Zharrez ose në një pozicion të barazvlefshme me të.

3) Detyrimin e punedhësit Albpetrol sh.a, Patos që të demshperbleje paditesin duke e kompensuar për demet pasurore të shkaktuara në formën e fitimit të munguar për mos marrjen e pages si shef i sektorit të stacionit Zharrez, nga momenti i pushimit nga puna me dt.27.02.2014 deri në rikthimin e tij në këtë punë



RR 019 344 422 AA

4) Detyrimin e punedhënesit Albpetrol sh.a, Patos qe te demshperbleje paditesin per demin jopasuror te pesuar.

5) Detyrimin e punedhënesit Albpetrol sh.a, Patos qe te paguaje shpenzimet gjyqesore dhe ato te perfaqesimit me avokat.

BAZA LIGJORE:

Nenet 17/2, 18, 33/1 dhe 49 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise; neni 14 i Konventes Europiane te Drejtave te Njeriut; nenet 31, 32/a, 153 dhe 154 te K.Pr.Civile; nenet 9, 10, 10/1 te K.Punes; nenet 3, 7, 12, 13, 34, 36, 37 dhe 38 te ligjit nr.10221, dt.04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi"; nenet 608, 609, 625 dhe 640 te K.Civil; vendimi unifikues nr.12, dt.14.09.2007, i Gjykates se Larte; vendimi nr.6, dt.17.02.2012, i Gjykates Kushtetuese.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. 62-2015-5367 (1599) dt. 02.12.2015 ka vendosur : *"Rrëzimin e padisë. Shpenzimet gjyqësore t'i ngarkohen paditësit....."*

Kundër vendimit të mësipërm ka bërë ankim pala paditëse e cila kërkon ndryshimin e vendimit duke e gjykuar çështjen në fakt me pasojë pranimin e padisë sipas objektit të saj, me saktësimin e vlerës së dëmit jopasuror të llogaritur në shkallë të parë në masën 4 162 882 lekë e të shpenzimeve gjyqësore në masën 189 620 lekë. Si shkaqe te ankimit evidentohen :

- Ndryshe nga sa arsyeton Gjykata e Shkallës së Parë në rastin konkret është provuar nga paditësi se ai është diskriminuar në mënyrën se si është trajtuar gjatë dhe në përfundim të marrëdhënies së punës, i vërtetuar ky fakt veç provave të tjera shkresore edhe me vendim të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili ka vendosur rregullimin e pasojave duke rikthyer gjendjen e mëparshme të punëmarrësit. Procedimi administrativ qe ka ndjekur paditesi ne kete rast nuk është kusht për të paraqitur kërkesëpadi në gjykatë. Barrën e pronës për të provuar mosekzistencën e sjelljes diskriminuese, në kushtet e prezumimit të diskriminimit, e ka pasur pala e paditur. Kjo e fundit nuk arriti të provonte në gjykim të kundërtën;

- Në kushtet kur provohet sjellja diskriminuese e pales së paditur ndaj punëdhënesit të saj [REDAKTUAR] gjatë dhe në përfundim të marrëdhënies së punës, Gjykata e Shkallës se pare duhej të kishte vendosur për dëmshpërblimin e paditësit, dëmshpërblim që përfshin ndër të tjera ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre permes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e duhur për dëmet pasurore si dhe jopasurore si dhe marrjen e masave të tjera të përshtatshme;

- Gjendja e faktit e provuar nga ana paditësit krijon premisat për zbatimin e neneve 608 dhe 625 e vijus të K.Civil sikunder keto dispozita janë interpretuar në Vendimin Unifikues Nr. 12 dt. 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në këtë rast konflikti gjyqësor buron nga marrëdhënia juridike e detyrimit jashtëkontraktor dhe duhet të rregullohet pikerisht nga dispozitat e posaçme të

legjislacionit në këtë fushë. Në rastin konkret ekziston dëmi, paligjshmëria e veprimeve të pales së paditur, ekzistenca e fajit dhe lidhja shkakësore. Padiësi në këtë rast ka pësuar një dëmtim në shëndet për shkak të këtij diskriminimi, sikundër ka qënë sëmundja e tij e rëndë dhe kalimi në parainfark me hipertension, sikundër përshkruhet në dokumentat mjekesore të lëshuara nga Spitali “[REDAKTUAR]” Tiranë.

- Në kushtet kur provohen të katër elementët e demit jashtëkontraktor, për lindjen e përgjegjësisë civile të pales së paditur, kjo e fundit duhet të dëmshpërblejë padiësin për dëmin pasuror që i ka shkaktuar dhe atë jopasuror (biologjik, moral dhe ekzistencial) të llogaritur nga eksperti në aktin e ekspertimit vlerësues.

- Gjykata e Apelit duhet të pranojë padinë, duke urdhëruar rikthimin e paditesit në vendin e mëparshëm të punës ose të një pozicioni të barasvlefshëm me të, pagimin e të gjitha pagave të pamara prej tij nga data 27.02.2014 deri në rikthimin e tij në detyrë (fitim i munguar) si dhe për vlerën e demit jopasuror në masën e llogaritur nga eksperti prej 4 162 882 lekë, bashkë me shpenzimet gjyqësore të cilat duhet t'i ngarkohen pales së paditur në masën prej 189 620 lekë.

GJYKATA E APELIT VLORE

- dëgjoi relatorin e çështjes Gjyqtare Brikena Ukperaj-Lubonja ;
- palën ankuese (palën padiëse) që kërkoi ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë sipas pretendimeve të mësipërme të ngritura në ankim;
- përfaqësuesin e palës së paditur që kërkoi lënien në fuqi të vendimit, dhe;
- si shqyrtoi e bisedoi çështjen në mungesë të personit të tretë;

V E R E N :

Padiësi [REDAKTUAR] ka qënë punëmarres i palës së paditur shoqëria Albpetrol sh.a, Patos. Marrëdhëniet e tij të punës pranë palës së paditur kanë filluar në dt. 20.07.2006 e kanë vazhduar deri në dt. 27.04.2014. Në zbatim të VKM-së nr. 106 dt. 01.02.2012 “Per trajtimin e punonjesve që dalin të papunë si pasojë e ristrukturimit të kompanisë Albpetrol sh.a, Patos”, në kuadër të procesit të ristrukturimit të palës së paditur, ai ka kërkuar për tu trajtuar nga kjo VKM, kërkesë që i është miratuar fillimisht. Padiësi është përfshirë edhe në listen përfundimtare të punonjesve që do të trajtoheshin nga kjo VKM të afishuar nga vete shoqëria Albpetrol sh.a, Patos.

I padituri Albpetrol sh.a, Patos nuk e ka trajtuar padiësin [REDAKTUAR] sipas VKM-se se cituar më sipër, por në dt.23.12.2013, e ka larguar nga vendi i tij i punës si Përgjegjës i Stacionit Zharrez dhe e ka kaluar në dispozicion të qendrave të prodhimit.

Në dt. 04.11.2013, Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a, Patos ka urdhëruar kryerjen e një hetimi administrativ për të verifikuar sasinë e naftës bruto në stacionet e Q.A.SH.N.G Patos, për periudhën 11-mujore të vitit 2013. Grupi i punës i ngritur nga Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a, Patos ka arritur në përfundimin se në Stacionin Zharrez, ku ishte përgjegjës padiësi [REDAKTUAR] ka rezultuar një diferencë prej 902 tone naftë bruto.

Administratori i Shoqerise Albpetrol sh.a, Patos, duke iu referuar perfundimeve te grupit te punes, ka zgjidhur kontraten e punes me paditesin Pajtim Brace, me vendimin nr.130, dt.27.02.2014.

Paditesi [REDAKTUAR] i eshte drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier me nje kerkese padi, nepermjet te ciles ka kerkuar demshperblimet perkatese, per shkak te zgjidhjes se kontrates se punes.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Fier, me vendimin nr.62-2014-3787 (1211), dt.27.10.2014, ka vendosur: "*Pranimin pjeserisht te padise; Detyrimin e te paditurit t'i paguaje paditesit nje demshperblim ne masen e pages se nje viti pune, per shkak te zgjidhjes se menjehershme dhe te pajustificuar te kontrates se punes; Detyrimin e te paditurit qe t'i paguaje paditesit pagen e tre muajve, te cilen paditesi do t'a kishte perfutuar nese marredheniet e punes do te kishin zgjatur deri ne perfundim te afatit te njoftimit; Detyrimin e te paditurit qe t'i paguaje paditesit 3.5 paga mujore, si shperblim per vjetersine ne pune; - rrezimin e padise per pjesen tjeter te saj.* Gjykata e Apelit Vlore, me vendimin nr.272, dt.05.03.2015, ka vendosur lenien ne fuqi te vendimit nr.62-2014-3787 (1211), dt.27.10.2014, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier. Pavarësisht masave të dëmshpërblimeve të dhëna nga Gjykata si me sipër, me vendim gjyqësor tashmë të formës së prerë është provuar se zgjidhja e njëanshme e kontratës së punës nga ana e palës së paditur, ka qenë e menjëhershme dhe e pajustificuar. Gjykata ka arsyetuar ndër të tjerash se nuk provohet lidhja shkakësore midis veprimeve apo mosveprimeve te paditësit referuar detyrave te tij funksionale si përgjegjës sektori dhe diferencave te naftës bruto te konstatuara.

Paditesi [REDAKTUAR] duke iu referuar veprimit të të paditurit për mos trajtimin e tij me VKM-ne nr.106, dt.01.02.2012 "Per trajtimin e punonjesve qe dalin te papune si pasoje e ristrukturimit te kompanise Albpetrol sh.a, Patos", ka pretenduar se ai eshte diskriminuar nga i padituri per shkak te gjendjes shendetesore dhe bindjeve te tij te politike, duke qene se eshte anetar i Partise Demokratike te Shqiperise.

Ne keto kushte, paditesi [REDAKTUAR] i eshte drejtuar Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi me ankesen nr.67 prot, dt.22.07.2014.

Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi, me vendimin nr.92, dt.05.06.2015, ka vendosur:

1. *Konstatimin e diskriminimit te drejtperdrejte te ankuesit [REDAKTUAR], per shkak te bindjeve te tij politike nga punedhenesi Albpetrol sh.a, Patos;*
2. *Konstatimin e mosdiskriminimit te ankuesit [REDAKTUAR] per shkak te gjendjes shendetesore, nga punedhenesi Albpetrol sh.a, Patos;*
3. *Detyrimin e shoqerise Albpetrol sh.a, Patos qe te ktheje ne menyre te menjehershme ne pozicionin e meparshem te punes ankuesin Pajtim Brace;*
4. *Detyrimin e te shoqerise Albpetrol sh.a, Patos qe te informoje brenda 30 ditesh Komisionerin lidhur me veprimet e ndermarra per zbatimin e ketij vendimi.*

Në vijim paditesi [REDAKTUAR], duke pretenduar faktin e diskriminimit dhe viktimizimit nga i padituri Albpetrol sh.a, Patos, **me rastin e mos trajtimit te tij me VKM-ne nr.106, dt.01.02.2012 gjatë marrëdhënies së punës si dhe për mënyrën se si atij i kanë përfunduar këto marrëdhënie**, bazuar në nenet 3, 7, 12, 13, 34, 36, 37 dhe 38 te ligjit nr.10221, dt.04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi", ka

kerkuar nga gjykata qe te konstatoje faktin e diskriminimit dhe te viktimizimit dhe te detyroje te paditurin qe t'a ktheje ne vendin e meparshem te punes, ne te njejtin pozicion pune apo ne nje tjetër te barazvlefshem me te, bashkë me pagimin e dëmshperblimeve përkatëse në formën e dëmit pasuror dhe jopasuror të pësuar.

Pala e paditur ka prapësuar në lidhje me të gjitha pretendimet objekt padie, duke e konsideruar vendimin e Komisionerit një akt absolutisht të pavlefshëm. Pala e paditur ka pretenduar veç të tjarash se paditësi i ka përfituar dëshpërblimet përkatëse tashme me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe nuk është diskriminuar apo viktimizuar nga punedhënësi.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka rrëzuar padinë duke arsyetuar se :

1. Nuk provohet fakti se veprimi i te paditurit Albpetrol sh.a, Patos për mos trajtimin e paditesit me VKM-ne nr.106, dt.01.02.2012, ka qene diskriminues dhe viktimizues ndaj tij. Gjykata referuar rrethanave të faktit te provuar ne gjykim, vlereson se nuk konstaton asnje element diskriminimi apo viktimizimi te paditesit [REDAKTUAR] nga i padituri Albpetrol sh.a, Patos, ne rastin e mos trajtimit te tij me dispozitat e VKM-se nr.106, dt.01.02.2012. Vetem fakti i qenies se paditesit anetar i Partise Demokratike te Shqiperise, eshte krejtesisht i pamjaftueshem per te arritur ne konkluzionin se ai eshte diskriminuar nga shoqeria ne rastin e mos trajtimit te tij me dispozitat e VKM-se nr.106, dt.01.02.2012. Paditesi nuk paraqiti asnje prove ne gjykim per te vertetuar faktin se veprimi i shoqerise ne rastin konkret eshte bere per shkak te bindjeve te tij politike. Perkundrazi, ne gjykim ka rezultuar i provuar fakti se disa dite perpara shpalljes se listes perfundimtare te punonjesve qe do te trajtoheshin me VKM-ne nr.106, dt.01.02.2012, Administratori i Shoqerise Albpetrol sh.a, Patos ka urdheruar kryerjen e nje hetimi administrativ per te verifikuar sasine e naftes bruto ne stacionet e Q.A.SH.N.G Patos, per periudhen 11-mujore te vitit 2013. Administratori i Shoqerise Albpetrol sh.a, Patos ka urdheruar kryerjen e ketij hetimi ne te gjithë sektoret e Q.A.SH.N.G Patos dhe jo vetem ne sektorin qe drejtonte paditesi [REDAKTUAR]. Per shkak te hetimit te nisur, paditesi eshte hequr nga lista e punonjesve qe do te trajtoheshin me VKM-ne nr.106, dt.01.02.2012 dhe ka vazhduar marredheniet e punes me te paditurin, duke qene ne dispozicion te qendrave te prodhimit.

2. Ne rastin konkret, nuk plotesohet asnje nga kushtet e parashikuara ne ligjin nr.10221, dt.04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi", ne menyre qe veprimi i te paditurit për mos trajtimin e paditesit me VKM-ne e sipercituar, te trajtohet si diskriminues dhe viktimizues.

3. Paditesi [REDAKTUAR] nuk provoi ne gjykim faktin se ai eshte trajtuar ne menyre te diferencuar ne raport me punonjesit e tjere, te cilet kane qene ne rrethana te njejta apo te ngjashme me te.

4. Ne kuptim te ligjit, trajtimi i diferencuar i subjektit qe pretendon se eshte diskriminuar, do te verifikohet ne raportin krahasues me trajtimin qe u eshte bere ne te njejten procedure, personave te tjere qe kane qene ne suate dhe rrethana te njejta apo te ngjashme me te. Paditesi pretendoi se ka qene ai i vetmi qe, megjithese ishte perfshire ne listen perfundimtare, nuk eshte trajtuar me dispozitat e VKM-se se sipercituar, nderkohe qe nuk solli asnje prove per te vertetuar kete fakt. Po keshtu,

duke iu referuar shkakut te pretenduar nga paditesi per heqjen e tij nga lista perfundimtare, gjykata vlereson se nuk rezultoi asnje e dhene ne gjykim per bindjet politike te punonjesve qe jane perfshire ne liste dhe kane perfituar apo te atyre qe mund te jene perjashtuar ne lista. Raporti krahasues ne trajtimin e te gjithë punonjesve te shoqerise Albpetrol sh.a, Patos, mund te behet vetem duke patur te dhena te plota ne kete drejtim, duke qene se paditesi pretendoi bindjet e tij politike si shkakun e heqjes se tij nga lista perfundimtare. Vetem te dhena te tilla mund te japin nje perfundim te sakte, ne kushtet kur i padituri ka mohuar qe te kene ndikuar bindjet politike te paditesit ne rastin konkret.

5. Paditesi [REDAKTUAR] nuk provoi ne gjykim se heqja e tij nga lista perfundimtare e punonjesve qe do te trajtoheshin me VKM-ne nr.106, dt.01.02.2012, eshte bere per shkak te bindjeve te tij politike, duke qene se ai eshte anetar i Partise Demokratike te Shqiperise. Paditesi nuk paraqiti asnje prove per te vertuar lidhjen e drejtperdrejte mes heqjes se tij nga lista perfundimtare dhe qenies se tij si anetar i Partise Demokratike te Shqiperise. Perkundrazi, nga aktet e paraqitura prej tij, ka rezultuar se heqja e tij nga kjo liste eshte bere per shkak te fillimit te hetimit administrativ mbi sasine e naftes bruto, midis te tjerave, edhe ne sektorin e tij.

6. Paditesi [REDAKTUAR] nuk provoi faktin se heqja e tij nga lista perfundimtare e punonjesve qe do te trajtoheshin me VKM-ne nr.106, dt.01.02.2012, i ka veshtiresuar apo i ka bere te pamundur ushtrimin e ndonje te drejte apo lirie themelore te njohur nga kushtetuta, aktet nderkombetare te ratifikuara apo ligjet e tjera ne fuqi. Kuvendi i Republikes se Shqiperise ka miratuar ligjin nr.10490, dt.15.12.2011 "Per percaktimin e formes dhe te struktures se formules se privatizimit te shoqerise Albpetrol sh.a, Patos". Ne mbeshtetje te neneve 4 dhe 8 te ketij ligji, Keshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr.106, dt.01.02.2012, "Per trajtimin e punonjesve qe dalin te papune nga procesi i ristrukturimit te shoqerise Albpetrol sh.a, Patos". Ne nenin 1 te VKM-se nr.106, dt.01.02.2012, parashikohet se *punonjesit e shoqerise Albpetrol sh.a, Patos, qe dalin te papune si pasoje e ristrukturimit, gjate periudhes nga data e hyrjes ne fuqi te ketij vendimi deri ne castin e privatizimit te shoqerise, pervec trajtimeve qe parashikohen nga Kodi i Punes, perfitojne per nje periudhe njevjecare, pagese sipas pages bruto te vitit te fundit te punes. Nga permbajtja e ketij neni rezulton se shoqeria Albpetrol sh.a, Patos do te trajtonte per nje periudhe njevjecare, me pagese sipas pages bruto te vitit te fundit, te gjithë punonjesit e saj, te cilet do te dilnin te papune, si pasoje e ristrukturimit te vete shoqerise per efekt te privatizimit te saj. Kete trajtim do t'a perfitonin te gjithë punonjesit e shoqerise qe do te dilnin te papune ne periudhen nga data e hyrjes ne fuqi te ketij vendimi deri ne momentin e privatizimit te shoqerise. Fakti qe paditesi [REDAKTUAR] nuk eshte trajtuar me dispozitat e kesaj VKM-je, nuk i ka sjelle si pasoje humbjen e ndonje te drejte apo lirie themelore te parashikuar ne kushtetute, aktet nderkombetare apo ligje te vecanta. Nepermjet ketij akti do te trajtoheshin punonjesit qe do te dilnin te papune si pasoje e ristrukturimit te shoqerise, nderkohe qe paditesi eshte hequr nga kjo liste dhe ka vazhduar marredheniet e punes me te paditurin.*

7. Duke qene se gjykata ka arritur ne perfundimin se nuk ka konstatuar asnje veprim diskriminues te te paditurit Albpetrol sh.a, Patos ndaj paditesit [REDAKTUAR] atehere nuk ka vend per ndreqje te ndonje shkeljeje ligjore apo per kompensime te tjera per shkak te diskriminimit.

8. Nenet 608 e vijues te K.Civil trajtojne pergjegjesine per shperblimin e demit ne marredheniet jashtekontraktore. Dallimi kryesor midis demit kontraktor dhe atij jashtekontraktor qendron ne faktin se demi kontraktor lind per shkak te mospermbushjes se detyrimeve kontraktore, nderkohe qe demi jashtekontraktor vjen si rezultat i nje sjelljeje te ndaluar nga ligji. Ky i fundit lind ne mungese te kontrates apo nuk ka te beje fare me kontraten. Ne baze te demit jashtekontraktor qendron ai fakt, i cili perben shkakun e nje demi pasuror ose jopasuror. Ky fakt mund te jete cdo sjellje e njeriut, ngjarje shoqerore apo fenomen i natyres, te ciles ligji i ngarkon nje pasoje juridike. Gjykata, duke iu referuar kesaj analize, vlereson se qendrimi paditesit eshte kontradiktor ne kete drejtim, pasi, nga njera ane pretendon se demi pasuror dhe jopasuror i eshte shkaktuar nga zgjidhja e kontrates se punes dhe nga ana tjetere, ai i eshte referuar neneve 608 e vijues te K.Civil, te cilat rregullojne pergjegjesine qe lind per shperblimin e demit ne marredheniet jashtekontraktore.

9. Palet ndergjyqese kane qene te lidhura ne nje marredhenie kontraktore me njera-tjetren, sikurse eshte kontrata e punes. Kontrata e punes e lidhur mes paleve ndergjyqese ka parashikuar, pervec te tjerave, edhe rastet e zgjidhjes se saj, si nje nga veprimet juridike dhe aspektet me te rendesishme te saj. Ne kete kontrate jane parashikuar veprimet e pales tjetere kontraktore qe mund te perbejne shkak per zgjidhjen e kontrates se punes. Nga ana tjetere, Kodi i Punes ka parashikuar ne menyre te qarte dhe te plote pergjegjesite qe lindin per punemarresin dhe punedhenesin ne rastin e mospermbushjes se detyrimeve kontraktore, vecanerisht ne rastin e zgjidhjes se kontrates se punes. Nenet 144/5, 145, 155/1 dhe 155/3 te K.Punes kane parashikuar pergjegjesine qe lind per punedhenesin per shperblimin e demit qe i shkaktohet punemarresit ne rastin e zgjidhjes se kontrates se punes ne kundërshtim me ligjin. Nga hetimi gjyqesor i kesaj ceshtjeje, ka rezultuar i provuar fakti se paditesi [REDAKTUAR] i ka fituar me vendim gjyqesor te formes se prere te gjitha te drejtat (demshperblimet perkatese) qe i takojne per shkak te zgjidhjes se kontrates se punes nga i padituri Albpetrol sh.a, Patos. Gjykata e Rrethit Gjyqesor Fier, ne vendimin nr.62-2014-3787 (1211), dt.27.10.2014, ka arritur ne perfundimin e zgjidhja e kontrates se punes se paditesit [REDAKTUAR] ka qene e menjehershme dhe e pajustificuar dhe ka vendosur detyrimin e te paditurit Albpetrol sh.a, Patos qe t'i paguaje demshperblimet perkatese. Ne rastin konkret, pergjegjesia e te paditurit Albpetrol sh.a, Patos eshte nje pergjegjesi qe lind nga kontrata e punes qe ka lidhur me paditesin [REDAKTUAR] perderisa edhe ky i fundit ka pretenduar se demi i eshte shkaktuar si rezultat i zgjidhjes se kesaj kontrate.

10. Paditesi [REDAKTUAR] e ka fituar me vendim gjyqesor te drejten e tij per t'u demshperblyer per zgjidhjen e padrejte te kontrates se punes nga i padituri Albpetrol sh.a, Patos. Demi qe i eshte shkaktuar paditesit [REDAKTUAR] ka ardhur si rezultat i zgjidhjes se padrejte te kontrates se punes nga i padituri, nderkohe qe ky i fundit nuk ka kryer asnje veprim tjetere qe nuk ka lidhje me kontraten e punes dhe qe t'i kete shkaktuar paditesit nje dem te ndryshem nga ai kontraktor.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit Vlorë

Gjykata e Apelit Vlorë vlerëson se vendimi Nr. 5367 (1599) dt. 02.12.2015 i Gjykatës se Rrethit Gjyqesor Fier, është marre në vlerësim të gabuar të provave

dhe për shkak të një orientimi jo të drejtë të procesit të të provuarit në këtë gjykim civil në lidhje me ekzistencën dhe cilësimin si diskriminues të sjelljes së palës së paditur gjatë dhe në zgjidhjen e kontratës së punës, cka ka reflektuar edhe në disponimin e saj në lidhje me dëmshpërblimet përkatëse të kërkuara, për pasojë ai duhet ndryshuar. Nga ana tjetër Gjykata e Shkallës së Parë bën kualifikim të drejtë të natyrës së marrëdhënies juridike që ka ekzistuar mes palëve, të rregulluar nga dispozitat e K.Punës, që përcaktojnë edhe masat e dëmshpërblimeve për zgjidhje të menjëhershme të pajushtikuar apo për motive abuzive ku bën pjesë edhe diskriminimi.

Ne nenin 1 të ligjit nr.10221, dt.04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" parashikohet : *Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtetëzarinë, perkatesinë prindërore, pergjegjesinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, perkatesinë në një grup të vecantë ose me çdo shkak tjetër.*

Ne nenin 3 të ligjit nr.10221, dt.04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" parashikohet : *Diskriminimi është çdo dallim, perjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo berjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet nderkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Diskriminimi i drejtëpërdrejtë është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtte apo të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.*

Ne nenin 7 të ligjit nr.10221, dt.04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" parashikohet *Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizike a juridike që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publike ose private, që krijojnë baza për rrahimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përben diskriminim.*

Ne nenin 12 të ligjit nr.10221, dt.04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" parashikohet : *Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose perjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarresve; c) trajtimin e punëmarresve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes apo ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisit të punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo*

lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontrates se punes; ç) anetaresine ne sindikata dhe mundesine per te perfituar nga lehtesite qe siguron kjo anetaresi.

Ne nenin 34 te ligjit nr.10221, dt.04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi" parashikohet se *cdo person ose grup personash qe pretendojne se ndaj tyre eshte ushtruar diskriminim per nje nga shkaqet e permendura ne nenin 1 te ketij ligji, mund te paraqesin kerkesepadi perpara gjykates kompetente sipas percaktimeve te Kodit te Procedures Civile, per demshperblim sipas ligjit ose, sipas rastit, te kryejne kallezimin perpara organeve kompetente per ndjekje penale.*

Paraqitja e ankimit perpara Komisionerit nuk eshte kusht per te paraqitur nje kerkesepadi dhe nuk perben pengese per personin e demtuar t'i drejtohet gjykates ose organeve te ndjekjes penale.

Nje organizate me interes te ligjshem ose komisioneri mund te paraqese padi ne emer te nje personi ose grupi personash, me kusht qe Komisioneri ose organizata te kete pelqimin me prokure te posacme ose me deklarim perpara gjykates te personit ose grupit te personave te demtuar nga diskriminimi.

Ne nenin 36 te ligjit nr.10221, dt.04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi" parashikohet se *padia i paraqitet gjykates kompetente nga nje prej subjekteve te parashikuara ne nenin 34 te ketij ligji jo me vone se 5 vjet nga dita qe ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo me vone se 3 vjet nga dita qe i demtuari merr dijeni per kete sjellje.*

I demtuari nuk ka detyrim te njoftoje Komisionerin para se te paraqese nje padi per diskriminim ne gjykate.

Gjykata e njofton Komisionerin per paraqitjen e cdo padie per diskriminim.

Gjykata mund t'i kerkoje Komisionerit, ne cdo faze te procedimit, qe te paraqese nje mendim me shkrim, rezultatet e hetimit te tij, ne qofte se eshte bere hetimi, ose cdo informacion tjeter qe ka rendesi per ceshtjen.

Paditesi ka detyrim te sjelle prova ne mbeshetje te padise, duke perdorur cdo lloj prove te ligjshme qe mund te provoje sjelljen diskriminuese.

Pasi paditesi paraqet prova, mbi te cilat bazon pretendimin e tij dhe ne baze te te cilave gjykata mund te prezumoje sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet te provoje se faktet nuk perbejne diskriminim sipas ketij ligji.

Ne nenin 37 te ligjit nr.10221, dt.04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi" parashikohet se *vendimi i gjykates cakton demshperblim nese gjykata vendos qe ka shkelje te ketij ligji, duke perfshire edhe nje afat kohor per kryerjen e zhdemtitimit.*

Vendimi i gjykates u komunikohet te gjitha paleve te interesuara, perfshire Komisionerin.

Vendosja e masave sipas ketij ligji, nuk perjashton vendosjen e masave sipas ligjeve te tjera.

Ne nenin 38 te ligjit nr.10221, dt.04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi" parashikohet se demshperblimi perfshin, nder te tjera, *ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe te pasojave te tyre permes kthimit ne gjendjen e meparshme, kompensimin e duhur per demet pasurore si dhe jopasurore, ose permes masave te tjera te pershtatshme.*

Nga permbajtja e neneve te cituara me siper, si edhe ne teresi e ligjit nr.10221, dt.04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi", rezulton se ato sigurojne mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje qe nxit diskriminimin per shkaqet e parashikuara ne nenin 1 te ketij ligji, ku perfshihen edhe bindjet politike te cdo personi apo grupi personash. Ky ligj siguron mbrojtjen nga diskriminimi te cdo personi apo grupi personash ne cdo fushe te veprimtarise se tyre perditshme, perfshire ketu edhe marredheniet e tyre te punes, per te gjitha shkaqet e parashikuara ne nenin 1 te tij.

Diskriminimi, sipas ketij ligji, eshte cdo dallim, perjashtim, kufizim apo preference, e cila bazohet ne shkaqet e parashikuara ne nenin 1 te tij dhe qe veshitoreson apo ben te pamundur ushtrimin ne menyre te njejte me te tjeret, te te drejtave dhe lirive themelore te njohura nga kushtetuta, aktet nderkombetare te ratifikuara dhe nga ligjet e tjera ne fuqi.

Ne kete kuptim, diskriminimi eshte nje forme sjelljeje, qendrimi apo veprimi, e cila, duke u bazuar ne shkaqet e listuara ne nenin 1 te ketij ligji, e dallon, perjashton apo kufizon personin apo grupin e personave ne ushtrimin e te drejtave dhe lirive te njohura, ne raport me persona te tjere ose grupe te tjera personash, kur ata ndodhen ne situata dhe rrethana te njejta apo te ngjashme. Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar i personit apo grupit te personave ne raport me te tjeret dhe qe ka si baze nje apo me shume nga shkaqet e parashikuara ne nenin 1 te ligjit te sipercituar. Diferenca ne trajtim qendron ne faktin se nje personi apo nje grupi te caktuar personash u krijohen veshtiresi apo u behet e pamundur ushtrimi i te drejtave dhe lirive te njohura, ne raport me te tjeret, kur te gjitha keta persona jane ndodhur ne rrethana te njejta apo te ngjashme.

Ne analize te dispozitave te cituara me siper, Gjykata e Shkallës së Parë ka vlerësuar drejt se per te qene perpara nje veprimi diskriminues ne kuptim te ketij ligji, duhet te plotesohen ne menyre te njekohshme keto kushte: - te ekzistojte nje trajtim i diferencuar i personit ne raport me te tjeret, te cilet ndodhen ne rrethana te njejta apo te ngjashme; - trajtimi i diferencuar te kete ndodhur per nje nga shkaqet e parashikuara ne nenin 1 te ketij ligji; - trajtimi i diferencuar te kete sjelle si pasoje veshtiresine apo pamundesine e ketij personi per te ushtruar te drejtat dhe lirite e njohura nga kushtetuta, aktet nderkombetare te ratifikuara apo ligje te tjera ne fuqi.

Ky ligj, pervece ka trajtuar diskriminimin ne te gjitha format e tij, si nje kategori te ndaluar te sjelljes, ka parashikuar edhe procedurat dhe mekanizmat e mbrojtjes prej tij.

Sipas ketij ligji, cdo person qe pretendon se i eshte nenshtuar apo eshte cenuar nga nje sjellje diskriminuese, ka te drejten qe t'i drejtohet Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi me nje kerkese me shkrim apo gjykates kompetente me kerkese pa. Personi mund t'i drejtohet drejtperdrejte gjykates pa qene i detyruar qe t'i drejtohet fillimisht Komisionerit.

Ne rastin kur personi qe pretendon se ndaj tij eshte ushtruar diskriminim, i eshte drejtuar gjykates kompetente me kerkese pa, **gjykimi zhvillohet mbi bazen e rregullave te parashikuara ne Kodin e Procedures Civile, duke perfshire edhe barr-en e proves. Personi qe pretendon faktin e diskriminimit eshte i detyruar qe te paraqese provat qe e vertetojne ate. Ne rastin kur subjekti qe pretendon**

diskriminimin i eshte drejtuar paraprakisht Komisionerit, vendimi i ketij te fundit, pavaresisht nese ka pranuar apo rrezuar kerkesen, sigurisht qe nuk eshte detyruar per gjykatën, ne kuptimin qe ajo eshte e detyruar qe t'a miratoje ate, pasi te kete verifikuar thjesht anen formale te tij, por ndryshe nga sa arsyeton Gjykata e Shkallës së Parë mundëson zhvendosjen e barrës së provës nga paditësi tek i padituri sikunder parashikon edhe neni 36 pika 6 e Ligjit 10221/2010, sepse në rast pranimit te kerkeses, përbën një provë nga përmbajtja e të cilës prezumohet shkelja diskriminuese.

Ky parim i orjentimit të barrës së provës në këtë gjykim civil nuk është zbatuar nga Gjykata e Shkallës së Parë, e cila nuk i ka dhënë asnjë vlerë juridike vendimit të Komisionerit si provë. Zbatimi i gabuar i parimit të barrës së provës në këtë rast e ka përqëndruar hetimin gjyqësor vetëm në provat e paraqitura nga paditësi, edhe pse ndryshe nga sa arsyeton Gjykata e Shkallës së Parë, nga analiza e tyre arrihet në konkluzionin sikunder ka bere edhe Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi, akt ky që është në fuqi pas ezaurimit edhe te ankimit në Gjykatë, se ekziston një prezumim i fortë i sjelljes diskriminuese të palës së paditur, në mënyrën në zgjidhjen e kontratës së punës së paditësit.

Gjykata e Shkallës së parë e ka analizuar sjelljen diskriminuese vetëm në lidhje me heqjen e paditësit nga lista e punonjësve që përfitonin nga VKM-ja 106, duke e konsideruar më vete këtë veprim si jodiskriminues, pa analizuar sjelljen e punëdhënesit që nga ky moment deri në muajin shkurt kur paditësit i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Ndryshe nga sa pretendon pala e paditur nuk i përket këtij këtij gjykimi vlerësimi i vlefshmërisë apo pavlefshmërisë se vendimit te Komisionerit si akt administrativ. Vetë pala e paditur e ka goditur kete akt ne Gjykatën administrative ku gjykimi është mbyllur nëpërmjet kthimit të akteve. Pavarësisht kësaj, në vlerësimin e Gjykatës së Apelit, në rastin konkret vendimi Nr. 92 dt. 05.06.2015 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për çka analizohet në të bashke me provat e tjera shkresore te depozituara nga paditësi, përbëjnë prova të mjaftueshme për prezumimin e sjelljes diskriminuese nga i padituri, i cili edhe pse ka pasur detyrimin nuk ka provuar që faktet e pretenduara nga paditësi për mënyrën se si ka ndodhur zgjidhja e kontratës së punës nuk përbëjnë diskriminim. Përkundrazi rezulton që pala e paditur të ketë ngritur në këtë gjykim të njëjtat prapesime që kishte ngritur edhe më parë në gjykimin e padise per dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme te pajustificuar të kontratës së punës.

Referuar dispozitave ligjore të mesipërme, në kushtet kur ka një vendim të Komisionerit që ka konstatuar diskriminim të drejtpërdrejtë të paditësit nga ana e punëdhënesit në lidhje me trajtimin gjatë marrëdhëniës e zgjidhjen e kontratës së punës, një disponim i tillë nuk mund të kryhet edhe nga Gjykata. Kjo e fundit do e konstatonte një fakt të tillë nëse nuk do të ishte ndjekur më parë rruga administrative, prandaj pretendimi objekt padie për konstatimin e faktit te diskriminimit dhe viktimizimit ndaj paditesit, të kryer nga ana e punedhënesit Albpetrol sh.a, Patos, duhet të rrëzohet, sikundër ka bërë edhe Gjykata e Shkallës së parë, por për shkaqet e përmendur në këtë arsyetim të Gjykatës së Apelit.

Në kushtet kur provohet shkelja e Ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" Gjykata bazuar në nenin 6 të K.Pr.Civile ka detyrimin e caktimit të dëmshpërblimit, i cili sipas nenit 38 të Ligjit, veç kompensimeve për dëmet pasurore e jopasurore,

parashikon edhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Por ky disponim i Gjykatës kushtëzohet nga natyra e marrëdhënies juridike mes palëve ku ka lindur sjella diskriminuose, në rastin konkret nga natyra e marrëdhënies së punës. Diskriminimi si motiv abuziv në zgjidhjen e kontratës së punës, parashikohet nga neni 146 i K.Punës, para ndryshimeve me Ligjin Nr. 136/2015 ku parashikohet :

“(1) Zgjidhja e kontrates nga punedhenesi, konsiderohet pa shkaqe te arsyeshme kur:

- a) punemarresi ka pretendime qe rrjedhin nga kontrata e punes;
- b) punemarresi ka permbushur nje detyrim ligjor;
- c) per motive te pandashme nga personeli i punemarresit, por qe nuk kane lidhje legjitime me raportet e punes. Konsiderohen si motive te tilla raca, ngjyra, seksi, moshja, gjendja civile, detyrimet familjare, shtatzania, besimi fetar, bindjet politike, kombesia, gjendja shoqerore.
- d) Per motive qe lidhen me ushtrimin nga punemarresi te nje te drejte kushtetuese, por qe nuk sjell shkeljen e detyrimeve qe rrjedhin nga kontrata e punes;
- e) Behet per motive te antaresimit ose jo te punemarresit ne sindikate per te krijuar ne baze te ligjit ose per shkak te pjesemarrjes se tij ne veprimtari sindikale ne baze te ligjit ...”.

Ne te gjitha keto raste i takon punemarresit, i cili është në rolin e paditesit, barra e proves per te provuar qe kontrata eshte zgjidhur per nje prej ketyre shkaqeve te paarsyeshme qe i kane cenuar atij te drejten per pune. Natyrshem, gjate gjykimit i takon punedhenesit e drejta qe te provoje te kunderten, pra qe ka pasur nje shkak tjetër te arsyeshem per zgjidhjen e kontrates. Te vetmet raste qe ligji mbron punemarresin jane ato te parashikuara ne piken 1 te nenit 146, rastet abuzive te zgjidhjes se kontrates prej punedhenesit. Pretendimi i ekzistences se nje (apo me shume) prej tyre vjen gjithmone nga punemarresi, i cili edhe duhet te provoje fillimisht pretendimet e tij se zgjidhja eshte bere pa shkaqe te arsyeshme.

Interpretimi i dispozitës së mësipërme është bërë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues Nr. 19 dt. 15.11.2007. Në rastin konkret për shkak të ekzistencës së prezumimit mbi diskriminimin në trajtimin e paditësit gjatë (duke filluar nga heqja nga lista e VKM 106) dhe në përfundim të marrëdhënies së punës, për të cilin nuk është provuar e kundërta nga pala e paditur, është arritur në konkluzionin se paditësit [redacted] i është cënuar e drejta për punë, prandaj në vlerësimin e Gjykatës së Apelit ai ka të drejtën e dëmshpërblimit që parashikon Kodi i Punës, konkretisht neni 146 i saj. Pavarësisht se një dispozitë e tillë nuk përmendet në bazën ligjore të padisë, referimi i drejtë në ligj nga ana e Gjykatës së Apelit nuk ndryshon shkakun ligjor të padisë në këtë rast. Paditësi kërkon të dëmshpërblehet për shkak të sjelljes diskriminuose, pavarësisht se referon në nenet 608 e vijues të K.Civil. Zbatimi një herë nga gjykata i nenit 155 të K.Punës në lidhjet me përfitimet që paditësi ka marre per zgjidhje te menjëhershme te pajustificuar nuk ezaurojnë zbatimin e nenit 146 të K.Punës, nëpërmjet te cilit paditësit i njihet e drejta për dëmshpërblim deri në 1 (një) vit pagë për shkak motovit abuziv (diskriminimi për bindje politike) në zgjidhjen e marrëdhënies së punës.

Neni 146 i K.Punës është dispozita që rregullon në këtë rast të gjitha “dëmshpërblimet” që mund të përfitojë punëmarrësi në rast të zgjidhjes së kontratës edhe për një motiv abuziv sikundër është diskriminimi për shkak të bindjes politike. Kjo dispozitë duhet interpretuar në përputhje edhe me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 18 të Kushtetutës ku parashikohet si një e drejtë themelore ajo e barazisë para ligjit dhe

e mosdiskriminimit në gëzimin e të drejtave. Me Protokollin 12 të KEDNJ-së ndalimi i diskriminimit është parashikuar edhe si një detyrim pozitiv për shtetet anëtare të KEDNJ-së me qëllim garantimin e masave mbrojtëse ndaj diskriminimit edhe kur ky ndodh mes palëve private. Në këtë mënyrë mbrojtja e KEDNJ-së mbi diskriminimin u zgjerua jo vetëm për të drejtat e parashikuara në Konventë, por edhe për çdo të drejtë tjetër të parashikuar në ligj. Në këtë frymë në K.Punës parashikohet në nenin 9 "Ndalimi nga diskriminimi" në fushën e marrjes në punë dhe të profesionit, duke nënkuptuar me to orientimin dhe formimin profesional, zënien me punë, kushtet e punësimit, shpërndarjen e punës, kryerjen e saj...ose edhe përfundimin e kontratës së punës.

Referuar nenit 146 të K.Punës, përcaktohet si rast i zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi për motiv abuziv, edhe kur ai kryhet për arsye të bindjeve politike. **Në rastin në shqyrtim për shkak të prezumimit të parrëzuar me prova të tjera nga pala e paditur, është vërtetuar përmes një procesi hetimi administrativ i kryer nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi se pala e paditur veç zgjidhjes se menjëhershme te pajustificuar te kontrates se punes se vërtetuar gjyqësisht, e ka zgjidhur këtë kontratë edhe për një motiv abuziv (bindja politike).** Prandaj diskriminimi që pala e paditur i ka bërë paditësit rezulton te ketë cënuar parimin e barazisë parashikuar nga neni 9 i K.Punës, sjellje e paligjshme që e cilëson zgjidhjen e kontratës si abuzive, në kuptim të nenin 146 pika c të K.Punës. **Për shkak te këtij kualifikimi juridik që Gjykata ka te drejtë t'i bëjë marrëdhënies mes paleve, në zbatim te nenit 16 të K.Pr.Civile, e palidhur me atë çka propozojnë palët, pa e ndryshuar shkakun e padise që konsiston në te drejtën e përfitimit të dëmshpërblimit për shkak diskriminimi, pretendimet e tjera objekt padie duhet të analizohen në përputhje me atë çka parashikon vetëm kjo dispozitë dhe jo nenet 608 e vijues të K.Civil.**

Në rrjedhë logjike të arsytimit të mësipërm paditësi [REDAKTUAR] ka të drejtën e dëmshpërblimit sipas kësaj dispozite deri në 1 (një) vit pagë, dëmshpërblim që i akordohet paditësit referuar rrethanave të tilla si kohëzgjatje e marrëdhënieve të punës, detyrimet personale dhe familjare, pritshmëri për punësim, shkallën e sjelljes diskriminuese, përfitimet e tjera të dhëna atij sipas nenit 155 të K.Punës. Mbi këtë bazë Gjykata e Apelit vlerëson se paditësi duhet të përfitojë si dëmshpërblim financiar atë me 12 (dymbëdhjetë) paga mujore për shkak të zgjidhjes së kontratës për motivin abuziv të diskriminimit për bindje politike.

Në lidhje me llojet e "dëmshpërblimeve" të tjera të kërkuara, Gjykata e Apelit konkludoi më sipër se, pavarësisht nenit 38 të Ligjit 10 221 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", ato nuk mund të dalin tej kufijve dhe parashikimeve të nenit 146 të K.Punës, i cili nuk njeh rikthim në punë për të punësuarit e shoqërive tregtare sikundër është pala e paditur në rastin konkret e për pasojë edhe të drejtën e pagës që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës deri në punësimin e ri rishtazi. Prandaj të dyja këto pretendime të paditësit duhet të rrëzohen për shkak të këtij arsytimi.

Në lidhje me figurat e dëmeve të pretenduara në përbërje të dëmit jopasuror, në rastin konkret jo vetëm nuk mund të qëndrojnë si figura të pavarura te parashikimeve të nenit 146 të K.Punës, por as provohet që paditësit t' i jetë shkaktuar pikërisht nga ky diskriminim një dëm më i madh shëndetësor, nuk provohet lidhja shkakësore me sëmundjen e pretenduar. Nga ana tjetër shkalla e mbulimit të përgjegjësisë së punëdhënësit i thirrur si i paditur në rastin konkret, ndaj punëmarrësit paditës, sipas nenit 146 të K.Punës, nuk mund të kalojë 12/muaj pagë.

Për sa u arsyetua më lart, Gjykata e Apelit Vlorë, i vlerësoi pjesërisht të mbështetura në ligjin material e procedural pretendimet e ngritura në ankimin e paditësit, prandaj pasi e shqyrtoi çështjen në fakt, vendosi ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me pasojë pranimin pjesërisht të padisë, me të drejtën e paditësit për të përfituar një dëmshpërblim në masën e 12 (pagave) mujore, referuar vlerës së pagës bruto që ai ka pasur në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Në lidhje me shpenzimet gjyqësore ato mbeten në ngarkim të palëve në masën 2/3 palës paditëse dhe 1/3 palës së paditur.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata e Apelit Vlorë, bazuar në nenin bazuar ne nenin 466 germa “b” të K.Pr.Civile;

V E N D O S I

Ndryshimin e vendimit Nr. 5367 (1599) dt. 02.12.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier si më poshtë :

1. Pranimin pjesërisht të padisë.
2. Detyrimin e palës së paditur Shoqëria Albpetrol sh.a Patos të dëmshpërblejë paditësin [REDACTED] me 12 (dymbëdhjetë) paga mujore, sipas vlerës së pagës bruto që ka pasur në momentin e përfundimit të marrëdhënies së punës.
3. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.
4. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palëve, 2/3 palës paditëse dhe 1/3 palës së paditur.

Vlorë, me 08.03.2018.

ANËTARE

ANËTAR

KRYESUES

MARGARITA BUHALI

NAZMI TROKA

BRIKENA UKPERAJ